# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6911
E premte, 2 qershor 2023
Çmimi 0.40 €

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


## Ish-kongresisti amerikan viziton prindërit e Thaçit në Burojë

FAQE 3



# BLINKENI REAGON SËRISH: KOSOVA DHE SERBIA T'I ULIN MENJËHERË TENSIONET NË VERI

FAQE 4-5




Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, u ka kërkuar krerëve të Kosovës dhe atyre të Serbisë që t'i ulin tensionet në veri, duke paralajmëruar se ata po rrezikojnë aspiratat e integrimit evropian. "Ne kemi qenë shumë të qartë në shqetësimet tona për disa nga veprimet e fundit që janë ndërmarrë. Këtë ua kemi thënë drejtpërdrejt liderëve të përfshirë, edhe kryeministrit Kurti", u ka thënë Blinken gazetarëve në Oslo të Norvegjisë. Duke folur pas një takimi të ministrave të Jashtëm të NATO-s në Oslo, Blinkeni tha se shumë aleatë u shprehën të shqetësuar për tensionet në veri të Kosovës. Edhe mëngjesin e së enjtes qytetarët serbë janë mbledhur sërish për të protestuar në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok kundër kryetarëve shqiptarë të këtyre komunave

## LIGJVËNËSIT AMERIKANË MBËSHTETIN KRIJIMIN E NJË TRIBUNALI PËR KRIMET RUSISË

FAQE 2



## ÇFARË HUMBI KOSOVA QË U PEZULLUA NGA "DEFENDER EUROPE '23"?

FAQE 7




## AKTUALE



### OSMANI TAKOHET ME ZELENSKYN NË MOLDAVI

F. 3

### DITA E FËMIJËVE, KURTI: INVESTIMI NË MIRËQENIEN E FËMIJËVE ËSHTË GURTHEMEL PËR SHOQËRI TË DREJTË

F. 5

### ABDIXHIKU E NJOFTON AMBASADORIN E FRANCËS PËR QËNDRIMET E LDK-së RRETH SITUATËS NË VERI

F. 3

## EKONOMI



### AEROPORTI "ADEM JASHARI" DO TË ZGJEROHET EDHE ME KATËR PORTA TË REJA

F. 8

### NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E GRANTIT PREJ 2.5 MILIONË EUROSH PËR KRU 'HIDROMORAVA'

F. 6

## SPORT



### 'FSHESA' E PRESIDENTIT TË DRITËS PO FUNKSIONIN, SHKON NË PESË NUMRI I LARGIMEVE

F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Ligjvënësit amerikanë mbështetin krijimin e një tribunali për krimet e Rusisë

**Uashington, 1 qershor** - Ligjvënësit në ShBA kanë shprehur mbështetje për krijimin e një tribunali ndërkombëtar të ndarë nga Gjykata Ndërkombëtare Penale (ICC) për t'i gjykuar krimet e agresionit që kanë ndodhur gjatë luftës në Ukrainë.
Si presidenti francez Macron, ashtu edhe presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, së fundmi kanë bërë thirrje për krijimin e një tribunali të tillë të pavarur ndërkombëtar.
Senatorët amerikanë dhe diplomatja e lartë amerikane për drejtësinë penale globale, Beth Van Schaack, diskutuan përpjekjet aktuale të ShBA-së për ta bërë gjykatën realitet në mënyrë që Rusia të mbahet përgjegjëse për krimet dhe agresionin ndaj Ukrainës.
Ky diskutim u mbajt gjatë një seance dëgjimore të Komisionit për Marrëdhëniet me Jashtë të Senatit më 31 maj.
Gjykata eventuale do të merrej me krimet e agresionit dhe jo me krimet kundër njerëzimit që aktualisht ndiqen penalisht nga ICC.
Van Schaack theksoi ndikimin e madh që do të kishte kjo gjykatë, duke deklaruar se këto përpjekje do të çonin në "gjyqin më të rëndësishëm në histori që nga Nuremburgu", një referencë për gjyqet e krimeve të luftës të mbajtura pas Luftës së Dytë Botërore, që rezultoi me dënime për shumë kriminelë nazistë të luftës.
Van Schaack dha implikimet ndërkombëtare, duke thënë se një gjykatë ndërkombëtare për krimet e agresionit ka të ngjarë ta implikojë Bjellorusinë për ndihmën në aktet e agresionit rus. Për më tepër, duke i parë në mënyrë specifike krimet e agresionit, diplomatja tha se gjykata mund ta ndjekë penalisht agresionin rus që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë në vitin 2014.
Departamenti amerikan i Shtetit shpreson gjithashtu se krijimi i një gjykate kundër agresionit do të dërgonte një mesazh ndërkombëtar kundër "shkeljeve të ngjashme flagrante të sovranitetit shtetëror", tha Van Schaack.
Për shkak se propozimi aktual bazohet në gjykatat ukrainase, komiteti ra dakord se do të duhej të kishte një mbikëqyrje të konsiderueshme dhe asistencë kapacitetesh nga partnerët ndërkombëtarë. Të gjithë anëtarët e komitetit pohuan përkushtimin e tyre ndaj llogaridhënies ruse, me një senator që tha se "mosndëshkimi nuk është një opsion".



# ShBA-ja jep 300 milionë dollarë ndihma ushtarake për Ukrainën

**Uashington, 1 qershor** - Shtëpia e Bardhë ka konfirmuar më 31 maj se do ta furnizojë Ukrainën me një pako të ndihmave ushtarake në vlerë prej 300 milionë dollarësh.
Në këtë pako përfshihen sisteme të mbrojtjes ajrore, municione dhe pajisje të tjera mbrojtëse.
Pentagoni bëri me dije se kjo është hera e 39 që dërgohen pajisje nga inventarët e Departamentit Amerikan të Mbrojtjes. Në mesin e pajisjeve do të jenë edhe bateri për sistemin e mbrojtjes ajrore Patriot, sistemet e mbrojtjes ajrore Stinger dhe municione tankesh.
Gjithsej, ShBA-ja ka dhënë më shumë se 38.3 miliardë dollarë ndihma ushtarake për Ukrainën që nga fillimi i qeverisjes së administratës të presidentit të ShBA-së, Joe Biden, përfshirë më shumë se 37.6 miliardë dollarë që nga nisja e pushtimit të paprovokuar të Ukrainës nga Rusia në shkurt të vitit të kaluar.
"Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë të punojnë me aleatët dhe partnerët e tyre për t'ia mundësuar Ukrainës përmbushjen e nevojave të saj të menjëhershme në fushën e betejës dhe kërkesat për asistencë afatgjatë të sigurisë", thuhet në deklaratën e Pentagonit.
Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë udhëhequr iniciativën me ndihma të paprecedenta të NATO-s dhe vendeve të tjera aleate për ta furnizuar Ukrainën me armatim dhe ndihma të tjera ushtarake.
Ndihmat e fundit ushtarake vijnë përderisa Ukraina po përgatit një kundërofensivë që synon t'i largojë forcat ruse nga pjesët e pushtuara në lindje dhe jug të Ukrainës.
Pentagoni tha se pakoja prej 300 milionë dollarësh përfshin raketa të mbrojtjes ajrore AIM-7, sistemet e mbrojtjes ajrore Avenger, municion për sistemet raketore HIMARS, fishekë artilerie, municion tankesh dhe raketa avionësh.
Pentagoni bëri me dije se në këtë pako përfshihen edhe më shumë se 30 milionë fishekë të armëve të vogla.



# NASA flet mbi UFO-t përpara raportit përfundimtar mbi objektet fluturake të paidentifikuara




**Nju-Jork, 1 qershor** - Agjencia Amerikane e Hapësirës, NASA, zhvilloi të mërkurën takimin e parë publik mbi UFO-t, një vit pasi nisi një studim mbi objektet fluturake të paidentifikuara.
Agjencia lejoi transmetimin televiziv të një seance dëgjimore prej disa orësh që përfshinte një panel me ekspertë të pavarur.
Ekipi përfshin 16 shkencëtarë dhe ekspertë të tjerë, mes tyre dhe austronauti që ka dalë në pension, Scott Kelly, amerikani i parë që qëndroi thuajse një vit në hapësirë. "Shumë anëtarë të komitetit kanë qenë objektivë i sulmeve dhe kërcënimeve në internet për shkak se kanë qenë pjesë e këtij ekipi, çka çon në shpërqendrim ndaj procesit shkencor", tha Dan Evans nga NASA, duke shtuar se ekipi i sigurisë së NASA-s po trajton këtë çështje. "Është pikërisht kjo qasje rigoroze, e bazuar në prova, që do ta mundësojë ndarjen e fakteve nga trillimet", tha Evans.
Studimi përfaqëson hapin e parë në përpjekjet për t'u dhënë shpjegim objekteve fluturuese misterioze që NASA i quan fenomene ajrore të paidentifikuara. "Ekipi po shqyrton se çfarë informacioni jo sekret disponohet mbi këtë temë dhe cilat janë nevojat e tjera për të kuptuar se çfarë po ndodh në qiell", tha astrofizikani David Spergel, kryetar i komitetit që drejton Fondacionin Simons.
Studimi nuk përfshin të dhëna ushtarake sekrete si, për shembull, të dhëna mbi balonën spiune kineze që fluturoi mbi territorin amerikan gjatë këtij viti.
Takimi u mbajt në selinë e NASA-s në Uashington, ndërsa publiku ndoqi diskutimet në distancë.
Raporti përfundimtar pritet të publikohet në fund të korrikut.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Ish-kongresisti amerikan viziton prindërit e Thaçit në Burojë



Skenderaj, 1 qershor - Ish-kongresisti amerikan Tony Hall ka vizituar prindërit e ish-presidentit Hashim Thaçi në Burojë të Skenderajt, raporton "Ekonomia Online".
Hall është pritur në odën e familjes Thaçi, nga babai i ish-presidentit, Haxhi Thaçi.
Me këtë rast Hall tha se u ndje i mirëpritur në shtëpinë e ish-kreut të UÇK-së. Ai shtoi se familjarët u shprehën të shqetësuar për gjykimin e bijve të tyre në Hagë, për çka tha se i mirëkupton. Madje tregoi se ka vizituar edhe një shoqatë të grave të dhunuara gjatë luftës.
Për këtë ai tha se duhet të ketë drejtësi, në mënyrë që të gjykohen krimet e jo të hetohen vetëm krerët e UÇK-së, duke e quajtur këtë drejtësi të njëanshme. "Qëllimi i vizitës ishte që ta takoja së pari babanë e ish-presidentit Hashim Thaçi, pastaj edhe familjarët e ish-liderëve që po mbahen në Hagë. Ai (babai i Thaçit) më priti shumë mirë. Mendova se po i bëja një nder por, në fakt, ai më bëri mua nder. U ndjeva shumë i mikpritur në shtëpinë e tij", ka thënë Hall.
Ai ka bërë me dije se është takuar edhe me familjarët e tjerë të liderëve të UÇK-së që po mbahen në Hagë. "Jam takuar edhe me familjarët e tjerë të ish-liderëve që po mbahen në Hagë. Ishte një takim shumë i mirë, por ata u shprehën të shqetësuar për sistemin e drejtësisë dhe unë i kuptoj plotësisht. Para se të vija këtu kam vizituar edhe një vend që kujdeset për gratë e dhunuara gjatë luftës. Më lë pa fjalë që 25 mijë vajza dhe gra kosovare janë përdhunuar gjatë luftës. Nuk duket të ketë drejtësi në të dyja anët. Njerëzit që kanë kryer këto krime duhet t'i paguajnë ato. Për mua kjo është drejtësi e njëanshme", ka thënë ish-kongresisti amerikan Tony Hall.





# Osmani takohet me Zelenskyn në Moldavi

Prishtinë, 1 qershor - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në margjinat e Samitit të Komunitetit Politik Evropian në Moldavi, është takuar me presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky. Osmani ka shpërndarë fotografi në "Facebook" nga bashkëbisedimi me Zelenskyn, derisa ka bërë me dije se atij i shpreh solidaritetin e popullit të Kosovës. "Asgjë nuk mund ta pengojë vullnetin e një populli për të qenë i lirë. Në emër të popullit të Republikës së Kosovës, i shpreha solidaritetin tonë të plotë presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy. Askush nuk e kupton dhimbjen dhe qëndresën e tyre më mirë se Kosova", ka thënë Osmani.

## Abdixhiku e njofton ambasadorin e Francës për qëndrimet e LDK-së rreth situatës në veri

Prishtinë, 1 qershor - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka pritur në takim ambasadorin e Francës në Kosovë, Olivier Guerot, me të cilin ka diskutuar për situatën aktuale politike në vend, me theks të veçantë për tensionet në veri. Abdixhiku e njoftoi ambasadorin Guerot për qëndrimet e LDK-së karshi kësaj situate, duke theksuar domosdoshmërinë e koordinimit të veprimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës me aleatët tanë si parakusht i stabilitetit afatgjatë. Kryetari i LDK-së shtroi edhe nevojën e mbështetjes ndaj institucioneve të rendit të Republikës me qëllim të garantimit të sigurisë së institucioneve dhe të qytetarëve përballë rrezikut të dhunës së krijuar nga bandat kriminale në veri të vendit.






# Blinkeni reagon sërish: Kosova dhe Serbia t'i ulin menjëherë tensionet në veri

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, u ka kërkuar krerëve të Kosovës dhe atyre të Serbisë që t'i ulin tensionet në veri, duke paralajmëruar se ata po rrezikojnë aspiratat e integrimit evropian. "Ne kemi qenë shumë të qartë në shqetësimet tona për disa nga veprimet e fundit që janë ndërmarrë. Këtë ua kemi thënë drejtpërdrejt liderëve të përfshirë, edhe kryeministrit Kurti", u ka thënë Blinken gazetarëve në Oslo të Norvegjisë. Duke folur pas një takimi të ministrave të Jashtëm të NATO-s në Oslo, Blinken tha se shumë aleatë u shprehën të shqetësuar për tensionet në veri të Kosovës. Edhe mëngjesin e së enjtes qytetarët serbë janë mbledhur sërish për të protestuar në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok kundër kryetarëve shqiptarë të këtyre komunave

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, sërish u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë të ndërmarrin hapa të menjëhershëm për uljen e tensioneve në veri të Kosovës. Ai ka paralajmëruar se situata aktuale i pengon proceset e integrimit euroatlantik për të dyja vendet. "Ne e mbështetim procesin e integrimit euroatlantik për Kosovën dhe Serbinë, por përshkallëzimi aktual më shumë i pengon sesa i ndihmon përpjekjet për të ecur në atë drejtim. Ne kemi qenë shumë të qartë në shqetësimet tona për disa nga veprimet e fundit që janë ndërmarrë. Këtë ua kemi thënë drejtpërdrejt liderëve të përfshirë, edhe kryeministrit Kurti", ka theksuar Blinken.

Blinken paralajmëroi kundër "veprimeve unilaterale" nga secila palë, pasi Serbia gjithashtu vuri ushtrinë e saj në gatishmëri. Ai tha se një e ardhme evropiane do t'i përmbushte "aspiratat e njerëzve në të dyja vendet". Duke folur pas një takimi të ministrave të Jashtëm të NATO-s në Oslo, Blinken tha se shumë aleatë u shprehën të shqetësuar për tensionet në veri të Kosovës.

Blinken ka shprehur shqetësimet e tij lidhur me situatën e krijuar në veri të Kosovës disa herë, duke i bërë thirrje edhe Kosovës, edhe Serbisë që t'i kthehen dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian për normalizimin e marrëdhënieve.

Edhe mëngjesin e së enjtes qytetarët serbë janë mbledhur për të protestuar në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok kundër kryetarëve shqiptarë të këtyre komunave. Tensionet në veri të Kosovës u rritën qysh më 26 maj, kur Policia e Kosovës i ndihmoi kryetarët shqiptarë të komunave me shumicë serbe të hyjnë në zyrat komunale, me gjithë rezistencën e banorëve lokalë.

Më 29 maj, nga përleshjet midis protestuesve serbë që kundërshtojnë kryetarët dhe ushtarëve të KFOR-it në Zveçan, 30 ushtarë mbetën të plagosur ashtu si dhe dhjetëra protestues.

NATO-ja ka thënë se është e gatshme të dërgojë edhe më shumë trupa në Kosovë për ta qetësuar dhunën në veriun e vendit, të banuar me shumicë serbe, tha të enjten shefi i aleancës, Jens Stoltenberg. Ai shtoi se 700 trupat e para përforcuese janë tashmë në rrugë për në Kosovë.

Udhëheqësit e 27 vendeve të Bashkimit Evropian dhe të 20 vendeve të tjera evropiane u mblodhën të enjten në Kishinjevë të Moldavisë për të diskutuar për një varg çështjesh, mes tyre edhe për tensionet në veri të Kosovës.

Përpara fillimit të samitit, përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka thënë se ata që shkaktojnë dhunë në veri të Kosovës duhet të mbajnë përgjegjësi për ato akte. "Më duhet të insistoj se dhuna nuk është zgjidhje. Dhuna duhet dënuar. Dhe autorët e kësaj dhune duhet të mbajnë përgjegjësi", ka theksuar Borrelli.

Kreu i diplomacisë evropiane paralajmëroi se duhen shmangur përshkallëzimi dhe lëvizjet e pakoordinuara. "Ne duhet ta shtensionojmë [situatën]. Ne duhet të qetësohemi. Ne kemi arritur në një pikë që është e domosdoshme që nivelet alarmante të dhunës të vërejtura në fillim të kësaj jave të ndalen menjëherë. Dështimi për ta bërë këtë mund të çojë në një situatë shumë të rrezikshme", u tha Borrell gazetarëve në Kishinjevë.

Një ditë më herët Borrelli ka takuar në Bratislavë kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti.

Shefi i politikës së jashtme i BE-së, Josep Borrell, ka thënë se ai i kishte kërkuar kryeministrit të Kosovës në Sllovaki, të mërkurën, që ta luante rolin e tij në zbutjen e krizës dhe shtoi se shpreson që të njëjtin mesazh t'ia transmetonte presidentit serb Aleksandër Vuçiq në Moldavi. "Ne kemi arritur në një pikë që është e domosdoshme që nivelet alarmante të dhunës të vërejtura në fillim të kësaj jave të ndalen menjëherë. Dështimi për ta bërë këtë mund të çojë në një situatë shumë të rrezikshme", ka thënë ai.

### Kosova dhe Serbia e fajësojnë njëra-tjetrën për tensionet në veri

Ndërkaq Kosova dhe Serbia vazhdojnë ta fajësojnë njëra-tjetrën për tensionet në veri. Presidentja Vjosa Osmani ka theksuar se Vuçiqi është i interesuar që nëpërmjet bandave të tij kriminale ta destabilizojë Kosovën. "Nuk duhet assesi që të lejojmë një gjë të tillë, prandaj koordinimi me aleatët tanë të cilët kanë qëndruar pranë nesh përgjatë kohëve më të vështira dhe gjatë sukseseve tona është kyç. Duhet të arrijmë bashkërisht që të shtensionohet situata dhe të shtyjmë përpara ide dhe propozime që kontribuojnë për paqe dhe stabilitet", është shprehur Osmani gjatë një deklarate para hyrjes në samitin e dytë të liderëve të Komunitetit Politik Evropian në Kishinau të Moldavisë.

Osmani ka theksuar se gjatë takimeve që do të ketë me liderë botërore do të kërkojë ndihmën e tyre për t'i luftuar grupet kriminale dhe strukturat ilegale në veri. "Nga Serbia kërkohet që t'i ndalë

veprimet destabilizuese dhe bandat e saj kriminale, sepse këto janë grupe që janë në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara, të Mbretërisë së Bashkuar dhe të disa shteteve të tjera dhe janë të kualifikuar si grupe transnacionale të krimit të organizuar që, ndër të tjera, janë duke terrorizuar edhe qytetarë serbë çdo ditë. Prandaj neve na duhet ndihma e miqve dhe aleatëve tanë që të jemi më të fokusuar dhe më të suksesshëm në luftimin e këtyre grupeve, por urdhri ndaj tyre vjen nga Vuçiqi. Dihet shumë mirë se kush i nxitë këto grupe që të përdoret dhunë në veri. Pra presioni duhet të jetë te Beogradi në mënyrë që ata ta ndalin dhunën", ka thënë Osmani.

Presidentja Osmani e ka përsëritur se Kosova është në favor të dialogut. "Vuçiqi vazhdimisht ka thënë se nuk do ta zbatojë atë për të cilën është pajtuar në Bruksel dhe në Ohër", është shprehur Osmani.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se "nuk e paramendon" zvogëlimin e pranisë së Policisë së Kosovës në komunat veriore të vendit pa u larguar "bandat kriminale të nacionalizmit e shovinizmit të djathtë ekstrem, të cilët i adhurojnë Millosheviqin dhe Putinin".

Kërkesën që njësitë speciale të Policisë së Kosovës të zëvendësohen me trupat e KFOR-it, e kanë paraqitur përfaqësuesit e Listës Serbe, si kusht për t'i tërhequr protestuesit serbë nga ndërtesat e komunave në veri, ku



edhe janë tubuar katër ditët e fundit. "Ata ose le të shkojnë në Serbi, ose duhet t'i çojmë në burg. Mirëpo, nuk ka mundësi që ne të mos i mbrojmë asetet dhe ndërtesat e republikës nga bandat e tilla. Kur ato të largohen ose mbyllen ne do të mund ta zvogëlojmë praninë", ka thënë Kurti të enjten.

Ai ka mbështetur edhe njëherë qëndrimin e tij se kryetarët e rinj të komunave në veri të Kosovës duhet të punojnë nga zyrat e tyre nëpër ndërtesa të komunave përkatëse. "Unë besoj që vendi i punës së kryetarit të komunës duhet të jetë në ndërtesën publike të komunës, sepse ndërtesa publike e komunës është ndërtesë e republikës", ka deklaruar Kurti.

Kryeministri vendosi një paralele mes gjendjes së krijuar në veri të Kosovës me gjendjen e jashtëzakonshme gjatë pandemisë Covid-19, duke kujtuar që askush nuk ka qenë në vend të punës për shkak se atë kohë "nuk kishte vaksina". "Mirëpo vendi i punës së kryetarit është në atë ndërtesë, dhe unë besoj se është mirë të gjithë të jenë atje... Ata kandidatë që kanë garuar dhe kanë fituar, duhet ta bëjnë punën, sepse për të paguhen. Unë besoj që vendi i punës së kryetarit të komunës duhet të jetë ndërtesa publike e komunës, sepse ndërtesa publike e komunës është ndërtesa e republikës", është shprehur Kurti.

Të dyja këto çështje të cilat i adresoi Kurti kanë të bëjnë me kërkesën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj Kosovës, të cilat i bëri të ditura ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier.

Kërkesat për qeverinë janë: të mos insistojë që kryetarët të punojnë nga ndërtesat komunale dhe t'i tërheqë zyrtarët policorë nga tri ndërtesat e komunave në veri. "Ne nuk e kuptojmë pse nuk mund të shfrytëzohen lokacione alternative, apo ndërtesa të tjera publike, për kryerje të funksioneve të tyre", ka theksuar Hovenier, duke kujtuar se kryetarët e komunave në fjalë janë betuar në lokacione alternative.

Presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, e ka hedhur fajin te kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Ai të enjten u ka bërë thirrje autoriteteve të Kosovës t'i tërheqin, siç i quajti ai, "kryetarët e supozuar" nga komunat me shumicë serbe në veri, për t'i ulur tensionet që kanë shkaktuar dhunë.

Duke folur pas mbërritjes në një samit të Komunitetit Politik Evropian në Moldavi, Vuçiqi tha se një hap i tillë do të ishte "lëvizja më e fuqishme" për zgjidhjen e krizës. Në një postim në llogarinë e tij në "Instagram", Vuçiqi ka theksuar se nuk pret takime të lehta me udhëheqësit evropianë në Moldavi. "Është e rëndësishme që ne të përpiqemi ta ruajmë paqen dhe stabilitetin", ka pohuar presidenti serb.

## Serbët po kushtëzohen për pjesëmarrje në protesta

Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, në "Facebook" ka shkruar se qytetarët serbë në komunat veriore janë të kushtëzuar që të dalin në protesta dhe organizime të drejtuara nga subjekti politik serb, Lista Serbe. "Serbët e Kosovës në vazhdimësi janë nën trysni dhe kërcënime që të kryejnë veprime jashtë vullnetit të tyre. Pas kushtëzimeve për të marrë pjesë në protesta dhe organizime të drejtuara nga Lista Serbe, protestuesit sot po detyrohen të nënshkruajnë në lista pjesëmarrjen e tyre në protestë. Haptazi ky është një mjet për të ndërmarrë veprime të mëvonshme ndaj atyre që nuk kanë qenë në protestë. Kjo mund të nënkuptojë kërcënime dhe dhunë fizike ndaj tyre dhe familjarëve, largime nga puna si dhe dëmtim të pronave të atyre personave", ka shkruar Sveçla. Ai ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të gjitha institucionet e sigurisë qëndrojnë të angazhuara dhe të përkushtuara maksimalisht në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit pa dallim. "Dënojmë ashpër veprimet e vazhdueshme të Listës Serbe dhe bandave kriminale të drejtuara nga ta, me porosi të Beogradit. Këto taktika duhet të ndalen që qytetarët serbë të Kosovës të jetojnë pa presione dhe kërcënime", ka shkruar ministri Sveçla.

# Dita e Fëmijëve, Kurti: Investimi në mirëqenien e fëmijëve është gurthemel për shoqëri të drejtë

EPOKA E RE
Faton DËRMAKU

Prishtinë, 1 qershor - Me rastin e shënimit të 1 Qershorit, Ditës së Fëmijëve, të enjten kryeministri Albin Kurti ka kryesuar takimin e radhës të Komitetit Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve. Përveç anëtarëve të këtij komiteti, të pranishëm ishin edhe Arbërie Nagavci, Albulena Haxhiu, Arben Vitia dhe Elbert Krasniqi, shefja e zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Nona Zicherman, udhëheqësja e KOMF-it, Donjeta Kelmendi, organizatat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si dhe vetë përfaqësuesit e fëmijëve.

Duke ritheksuar përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për mirëqenien e fëmijëve, kryeministri Kurti në këtë takim ka theksuar se investimi në mirëqenien e fëmijëve është gur themel për shoqëri të drejtë. Rrjedhimisht, ai tregoi se si qeveri përmes skemave të mbrojtjes sociale dhe politikave arsimore po i largojnë barrierat për zhvillimin dhe arsimimin e fëmijëve. "Paralelisht, për të siguruar barazi nga mosha e hershme, po i ndajmë shtesat për 351 mijë fëmijë nën moshën 16-vjeçare. Ndërkaq, është miratuar edhe Ligji për Arsimin e Fëmijërinë e Hershme, ku do të angazhohen 500 asistentë për fëmijë me aftësi të kufizuara e me nevoja të veçanta. Në këtë kuadër, sa i përket shëndetit mendor dhe psiko-social të fëmijëve dhe familjeve të tyre, vetëm në vitin e kaluar janë trajnuar mbi 200 profesionistë të këtyre shërbimeve", ka thënë Kurti.

Sipas kryeministrit, janë themeluar dhe funksionalizuar mekanizma institucionalë për të drejtat e fëmijëve në nivel qendror dhe lokal, ku deri më tani janë themeluar ekipet për të drejtat e fëmijës në 22 komuna dhe janë realizuar aktivitete në 32 komuna nga Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Këto ekipe për të drejtat e fëmijëve, ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, i konsideroi hapa të rëndësishëm drejt ndërgjegjësimit, aktorëve të rëndësishëm të përfshirë në sigurimin e të drejtave të fëmijëve. Ai shprehu se do të vazhdojnë tutje duke punuar së bashku për t'i adresuar çështjet dhe problemet me të mëdha që fëmijët tani po përballen.




Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, gjatë takimit ka shpalosur dhe i ka njoftuar të pranishmit me politikat e kësaj ministrie në edukimin e hershëm, duke theksuar se edukimi në fëmijërinë e hershme mbetet një nga prioritetet e Ministrisë dhe Qeverisë, me synimin parësor rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin e hershëm dhe ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët në të gjitha komunat e republikës sonë.

Ndërkaq, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, është shprehur i lumtur që ishte në këtë tryezë dhe se si Ministri e Shëndetësisë synojnë zhvillimin e shërbimeve cilësore shëndetësore me qasje të lehtë për nëna dhe fëmijë si dhe qasje bashkëkohore që do të rezultojë në përmirësimin e statusit shëndetësor të këtyre grupeve të ndjeshme të popullatës si dhe ngritjen e kualitetit të tyre.

Në takim nuk mungoi as prania e fëmijëve, me ç'rast Esra Kërveshi, kryetare e Grupit Avokues të fëmijëve me aftësi të kufizuar, falënderoi kryeministrin Albin Kurti që ndau kohën t'i dëgjojë kërkesat e tyre. Në fund, kryeministri Albin Kurti kërkoi që të gjitha rekomandimet nga ky takim i sotëm t'i përkthejmë në veprime të përbashkëta, të institucioneve dhe organizatave partnere vendore e ndërkombëtare, në angazhim të përbashkët me fëmijët. Ndërsa fëmijëve, duke iu uruar përzemërsisht ditën e tyre, 1 Qershorin, i këshilloi ta ruajnë gjithmonë ndjeshmërinë, kreativitetin dhe kureshtjen që karakterizon moshën e fëmijërisë.

## Ndriçohen rreth 100 mijë metra rrugë publike në komunën e Drenasit



DRENAS, 1 QERSHOR - Për më pak se dy muaj është bërë ndriçimi i rreth njëqind mijë (100 000) metrave rrugë publike në territorin e komunës së Drenasit, përkatësisht në fshatrat Tërdec, Abri, Damanek, Krajkovë, Llapushnik, Korroticë, Nekoc, Tërstenik, Polluzhë, Vërboc, Shtuticë, Gllanasellë, Dobroshec dhe Poklek. Drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, Endrit Gllareva, me bashkëpunëtorë, bëri inspektimin e punimeve në lagjen Dvorani në fshatin Tërstenik, dhe jo vetëm, pasi në proces të vendosjes së ndriçimit publik janë edhe shumë rrugë të tjera, ku së shpejti pritet të përfundojnë të gjitha rrugët publike në komunën e Drenasit.

Ky projekt, por edhe projekte të tjera infrastrukturore, janë planifikuar në mënyrë që qytetarët ta kenë sa më të lehtë kryerjen e çdo shërbimi në fshatin, vendbanimin ku jetojnë. Mbetemi të përkushtuar për realizimin e projekteve në të mirën e përgjithshme për qytetarët e komunës së Drenasit.

# Përurohet çerdhja në Ratkoc të Rahovecit



RAHOVEC, 1 QERSHOR - Me rastin e 1 Qershorit - Ditës së Fëmijëve - në Ratkoc të Rahovecit është përuruar çerdhja e re. Vlera e ndërtimit të këtij objekti është 508.260,43 euro. Kjo çerdhe përmban tri klasa për grupmoshat 2-3 vjeç, me gjithsej 82 fëmijë; katër klasa për grupmoshat 4-5 vjeç, me gjithsej 94 fëmijë; dy mensa, në të cilat mund të ushqehen njëkohësisht gjithsej 76 fëmijë; dhomë gjumi me 26 shtretër; zyrën e drejtorit/drejtoreshës; zyrën e mjekut; zyrën e administratës për katër persona; zyrën e pranimit; zyrën e psikologut/pedagogut; zyrën e sekretarit; nyjat sanitare; dhe korridore dhe hapësira të tjera, të mjaftueshme për stafin dhe fëmijët. "Ne nuk do të ndalemi asnjëherë që fëmijëve tanë t'u ofrojmë kushte sa më të mira për ta", ka thënë kryetari Latifi.

# Nënshkruhet marrëveshja e grantit prej 2.5 milionë eurosh për KRU 'Hidromorava'




PRISHTINË, 1 QERSHOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, shefi i zyrës të BERZh-it në Kosovë, Sergiy Maslichenko dhe sekretari gjeneral i "Hidromoravës", Agim Smillaku, kanë nënshkruar të enjten marrëveshjen e grantit prej 2.5 milionë eurosh për KRU "Hidromorava". Më saktësisht, granti përfshin 1 milion euro për zgjerimin e rrjetit të ujërave të zeza, ndërsa 1.5 milion euro për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza.

Projekti për trajtimin e ujërave të zeza në Gjilan kap vlerën totale prej 23.5 milionë eurosh, për të cilat tashmë është siguruar financimi.

Implementimi i projektit është në fazën përgatitore dhe deri në fund të vitit pritet të fillojnë punimet në terren. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje është tejet me rëndësi për regjionin e Anamoravës, pasi përforcon kapacitetet e KRU "Hidromorava" dhe përmirëson kushtet e ambientit përmes trajtimit të ujërave të zeza për rreth 76 mijë qytetarë.

## Po vazhdon vendosja e rrethojave në parqet e Prizrenit



PRIZREN, 1 QERSHOR - Po vazhdon vendosja e rrethojave në parqet e gjithë komunës së Prizrenit. Tashmë ka përfunduar një pjesë e këtij projekti në lagjen Ortakoll, në afërsi të shkollës "Abdyl Frashëri". "Kufizimi i hapësirave të gjelbëruara publike shton vlerën e qytetit. Ta ruajmë bashkë ambientin e Prizrenit tonë", është shprehur kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj.

# Çfarë humbi Kosova që u pezullua nga “Defender Europe ’23”?




PRISHTINË, 1 QERSHOR - Gati dy vjet. Kjo është periudha kohore që Ministria e Mbrojtjes e Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës shpenzuan për t’u bërë gati për stërvitjen më të madhe të aleatëve të NATO-s në Ballkan, e njohur si “Defender Europe ’23”.
Ani pse Kosova ishte një nga vendet nikoqire të kësaj stërvitjeje, ajo nuk mundi ta çonte deri në fund aktivitetin pasi, më 30 maj, ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, tha se “për Kosovën, ato stërvitje kanë marrë fund”.
Ky është ndëshkimi i parë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndërmorën kundër Kosovës për, siç u tha, injorimin e këshillave të tyre për ta shmangur rritjen e tensioneve në zonën veriore me shumicë serbe.
Në këtë zonë, prej ditësh, banorët lokalë protestojnë kundër kryetarëve shqiptarë të komunave Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.
Tensionet kulmuan më 29 maj, kur protestuesit u përleshën me pjesëtarë të misionit paqeruajtës të NATO-s, KFOR, në Zveçan. Dhjetëra njerëz në të dyja anët mbetën të plagosur.
Një ditë pas përjashtimit të Kosovës nga “Defender Europe ‘23”, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha për “Radion Evropa e Lirë” se kjo është një “fatkeqësi”. “Nuk mendoj se [përjashtimi] është i drejtë, por kush jam unë të vendos”, tha Kurti, duke mbrojtur veprimet e qeverisë së tij në veri.

### Kosova po përfitonte nga partneriteti me aleatët

Kosova humbi një mundësi shumë të madhe që ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e Forcës së Sigurisë së Kosovës të marrin një përvojë të çmuar nga shtetet e NATO-s, thotë ish-komandanti i FSK-së, Kadri Kastrati, për “Radion Evropa e Lirë”.
Kastrati, i cili udhëhoqi FSK-në nga viti 2011 deri më 2015, përmend edhe tri humbje të tjera të konsiderueshme për Kosovën: humbjen e mundësisë për krijimin e urave të miqësisë, humbjen e mundësisë për ndërveprime ushtarake dhe humbjen e mundësisë për ta rritur përvojën në përdorimin e armatimeve të ndryshme.
Kastrati thotë se FSK-ja ka qenë duke ndërtuar një autoritet të respektueshëm te partnerët ndërkombëtarë, në veçanti me ShBA-në.
Nga ky partneritet, kujton ai, pjesëtarë të FSK-së, në disa raste, janë dërguar në misione paqeruajtëse jashtë vendit.
Ai thotë se Shtetet e Bashkuara, në vazhdimësi, kanë qenë partnere strategjike të Kosovës, si në planifikim, krijim dhe zhvillim të FSK-së. “Por, nëse vazhdohet kështu, dyshoj se do të jetë njëjtë tani e tutje”, shprehet Kastrati.
Stërvitjet “Defender Europe ‘23” nisën më 21 maj në Kosovë dhe ishte e paraparë të zgjasnin deri më 2 qershor.
Mistria e Mbrojtjes e Kosovës nuk e komentoi drejtpërsëdrejti suspendimin e pjesëmarrjes së Kosovës në stërvitjen “Defender Europe ‘23”, por tha se është arritur objektivi që kishte. Sipas një postimi të ministrit Armend Mehaj në “Facebook” më 30 maj, 1 348 ushtarakët e FSK-së treguan profesionalizëm të lartë në mesin e 25 shteteve pjesëmarrëse të këtij ushtrimi si dhe gatishmëri për të shërbyer përkrah aleatëve në çdo mision të NATO-s, “me qëllim ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në vend, rajon dhe më gjerë”.

### Në cilën fazë ishte “Defender Europe ‘23”?

Ky ishte viti i dytë që Kosova merrte pjesë në këtë stërvitje shumëkombëshe dhe që ishte nikoqire e saj. Në këtë ushtrim marrin pjesë 25 shtete, përfshirë ShBA-në, Francën, Gjermaninë, Spanjën, Mbretërinë e Bashkuar, si dhe shtete të tjera anëtare dhe joanëtare të NATO-s.
Numri i përgjithshëm i ushtarëve pjesëmarrës në këtë ushtrim ishte rreth 20 mijë.
Stërvitja “Defender Europe ‘23” po mbahet në disa lokacione në të gjithë Evropën, ndërsa në Kosovë u zhvillua në dy lokacione, në Babaj të Bokës dhe në Aeroportin e Gjakovës.
Në kohën kur u njoftua suspendimi i pjesëmarrjes së Kosovës nga ShBA-ja, aktivitetet e Kosovës në kuadër të “Defender Europe ’23” ishin afër fundit.
Për 30 maj ishte paraparë ditë e hapur për vizitorë dhe ky është aktiviteti kryesor që nuk u mbajt si pasojë e pezullimit që u shpall nga ambasadori amerikan Hovenier. Për ditët deri në mbyllje të ushtrimit më 2 qershor ishin paraparë aktivitete kryesisht të përgatitjes për dislokimin e trupave pjesëmarrëse dhe aktivitete formale përmbyllëse.
Në të njëjtën kohë si në Kosovë, ushtrime u zhvilluan edhe në Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Kroaci, Slloveni e të tjera. FSK-ja kishte pjesëmarrje edhe në shtete të tjera, përfshirë 160 ushtarë të një njësie të këmbësorisë në Maqedoni të Veriut dhe 60 të tjerë të përfshirë në sektorin e inteligjencës dhe zbulimit, si dhe në çminim në Kroaci. Në Shqipëri, ndërkaq, 60 pjesëtarë të tjerë të FSK-së ishin të përfshirë në njësinë për materiale të rrezikshme.
Stërvitja “Defender Europe 23”, e cila udhëhiqet nga ShBA-ja, ka qëllim krijimin e gatishmërisë dhe ndërveprueshmërinë në mes të Shteteve të Bashkuara, NATO-s dhe vendeve partnere.
Stërvitja “Defender Europe 23” thuhet se është projektuar për t’i demonstruar aftësitë e ushtrisë së ShBA-së, për të dislokuar me shpejtësi trupa dhe pajisje të fuqishme luftarake, për t’i siguruar aleatët dhe për ta penguar këdo që kërcënon paqen në Evropë si dhe për ta mbrojtur kontinentin nga agresioni.

### Rëndësia e ShBA-së në zhvillimin e FSK-së

Forca e Sigurisë së Kosovës është themeluar në vitin 2009 kur qenë shuar Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Në vitin 2014 nisën përpjekjet për transformimin e misionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, që nënkuptonte zgjerim të kompetencave edhe në mbrojte të territorit. Ky proces nuk ishte i mundur të bëhej përmes ndryshimeve kushtetuese dhe transformimi nisi përmes ndryshimeve ligjore në vitin 2018.
NATO-ja e kundërshtoi vendimin e Kuvendit të Kosovës për shndërrimin e FSK-së në ushtri të vendit, por ShBA-ja e mbështeti këtë proces, sidomos zhvillimin e kapaciteteve.
Kur transformimi i FSK-së në ushtri po kundërshtohej nga NATO-ja, ambasadori i atëhershëm amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, deklaroi se “është më se e natyrshme për Kosovën, si vend sovran dhe i pavarur, që të ketë aftësi vetëmbrojtëse”.
Në partneritet me ShBA-në, në vitin 2021 kontingjenti i parë i FSK-së shkoi në mision paqeruajtës jashtë vendit dhe këtij institucioni iu premtua mbështetje e vazhdueshme amerikane. Por, pas suspendimit të FSK-së nga pjesëmarrja në “Defender Europe ’23”, ka shqetësime të shumta nëse do të vazhdojë edhe më tej mbështetja amerikane për ushtrinë e Kosovës.
Ambasadori Hovenier tha se ShBA-ja po shqyrton edhe masa të tjera për Kosovën dhe se, aktualisht, “nuk ka entuziazëm” për ta ndihmuar atë në përpjekjet e saj për të fituar njohje më të madhe ndërkombëtare ose për të përparuar drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe në NATO.



# Aeroporti "Adem Jashari" do të zgjerohet edhe me katër porta të reja

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Në mbledhjen e fundit të Komitetit për Partneritet Publiko-Privat është miratuar kërkesa e koncesionarit LKIA për shtimin edhe të katër portave të reja të imbarkimit (boarding gates), duke e rritur kështu numrin e portave nga 8 në 12 gjithsej.
Ministria e Financave ka njoftuar se zgjerimi i terminalit do të bëhet në anën jugore dhe në anën veriore të portave ekzistuese të imbarkimit, ndërsa buxheti i paraparë për këtë plan në total është rreth 3 milionë euro. "Meqenëse plani i zgjerimit bie nën kompetencat e partnerit privat, zgjerimi i terminalit do të bëhet pa asnjë shpenzim shtesë për Dhënësin apo Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ky zgjerim synon ta rrisë kapacitetin e terminalit për të përballuar flukse më të mëdha të udhëtarëve, por edhe rritjen e komoditetit për pasagjerët që ta kenë sa më të lehtë kalimin nëpër kontrollet e aeroportit", është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Financave.
Gjatë mbledhjes Komiteti miratoi edhe raportin vjetor për vitin 2022 si dhe diskutoi mbi kërkesën e partnerit privat për zgjatjen e afatit të koncesionimit me qëllim reflektimin e kohës së pandemisë ashtu siç parashihet në kontratë.
Sipas raportit mbi pasqyrat financiare të Auditorit të Pavarur, të ardhurat bruto për vitin 2022 ishin 60,177,176 euro apo 36.91 për qind më të larta sesa viti paraprak, ndërkaq numri i udhëtarëve u rrit nga 2,198,414 në 3,012,108 pasagjerë, që paraqet një rritje prej 37-përqindësh.




# Dhoma e Përfaqësuesve miraton ligjin për rritjen e tavanit të borxhit

UASHINGTON, 1 QERSHOR - Dhoma e Përfaqësuesve ka miratuar ligjin për rritjen e tavanit të borxhit federal, të bazuar në marrëveshjen mes presidentit Joe Biden dhe kryetarit republikan të Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy. Ligji, i cili u miratua me 314 vota për dhe 117 kundër, tani duhet të miratohet nga Senati para se ta marrë nënshkrimin e presidentit Biden.
Presidenti Biden dhe kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy, u angazhuan me intensitet të lartë për të siguruar mbështetje për miratimin e ligjit për rritjen e tavanit të borxhit, që përfshin edhe shkurtimet buxhetore të kërkuara nga republikanët.
Sekretarja e Thesarit, Janet Yellen, paralajmëroi javën e kaluar se Kongresi duhet ta rrisë kufirin e borxhit deri më 5 qershor, përndryshe qeveria nuk do të jetë në gjendje t'i përmbushë detyrimet financiare. Ajo tha se edhe pritja deri në minutën e fundit mund ta dëmtojë seriozisht besimin e biznesit dhe të konsumatorëve dhe të ndikojë negativisht në vlerësimin e kreditit të vendit.



Ligji përfshin heqjen e kufirit ekzistues të huamarrjes deri në janar të vitit 2025 dhe një marrëveshje buxhetore dyvjeçare që i mban shpenzimet federale të pandryshuara në vitin 2024 dhe i rrit ato me 1 për qind në vitin 2025.
Pjesë të tjera përfshijnë një pakësim të numrit të agjentëve të rinj që do të punësojë agjencia e grumbullimit të taksave, një kërkesë që shtetet të kthejnë 30 miliardë dollarë ndihma të pashpenzuara të marra për pandeminë e koronavirusit nga qeveria federale dhe rritjen nga 50 në 54 vjeç për grupmoshat që duhet të punojnë, që të kualifikohen për ndihma ushqimore.
Udhëheqësit e Senatit kanë paralajmëruar se do ta marrin për shqyrtim ligjin e miratuar nga Dhoma e Përfaqësuesve për rritjen e tavanit të borxhit të premten.

## Inflacioni po 'tkurr' pagat reale në Gjermani

BERLIN, 1 QERSHOR - Inflacioni i lartë në Gjermani, edhe pse u duk se justifikoi rritjen e pagave në ekonominë më të madhe të Evropës, në fakt bëri që pagat reale të bien me 2.3 për qind në tre muajt e parë të këtij viti. Të dhënat e konfirmuara nga Zyra Federale e Statistikave (Destatis) thonë se pagat nominale në Gjermani u ritën 5.6 për qind nga viti në vit në tremujorin e parë 2023, rritja më e madhe që nga 2008.
Megjithatë, ashtu si në vitin 2022, pagat nuk po rriteshin aq shpejt sa për të vazhduar me inflacionin dhe, si rezultat, pagat reale në vend ranë me 2.3 për qind në tremujorin e parë.
Ekspertët parashikojnë se me inflacion kaq të lartë në fillim të vitit, pagat reale mesatare mund të bien më tej në vitin 2023, i cili do të ishte viti i katërt radhazi i rënies së të ardhurave reale në Gjermani.
Në Gjermani, ashtu si në vendet e tjera të Evropës, negociatat e marrëveshjeve kolektive dhe grevat kanë paralizuar vazhdimisht vendin gjatë muajve të fundit. Punonjësit e hekurudhave, për shembull, kërkojnë 12 për qind rritje page, ose një rritje prej 650 eurosh në muaj.
Ekspertët paralajmërojnë se ekziston rreziku që kërkesat e tepërta të pagave dhe rritja prej 12-përqindësh do ta nxisë inflacionin edhe më tej dhe se spiralja e çmimit të pagave do të vazhdojë të rrotullohet në mënyrë të pashmangshme.



# A është një përrallë, çdo tregim?



Nga: Gabriel García MÁRQUEZ (Revista *Cambio*, 24 korrik 2000)
Përktheu: Bajram Karabolli

Të shkruash një roman do të thotë të bësh mur me tulla. Të shkruash një tregim do të thotë të bësh mur betoni. Nuk e di e kujt është kjo frazë e saktë. E kam dëgjuar dhe e kam përsëritur aq shumë sa ndoshta dikush mund të ketë besuar, se kjo ishte thënia ime. Ka edhe një krahasim tjetër që nuk është aq i fortë sa i mëparshmi: tregimi është të qëllosh me shigjetë në qendër të tabelës, ndërsa romani është të gjuash lepujt. Sidoqoftë, kjo pyetje e lexuesit ofron një mundësi të mirë që, si gjithmonë, të vrasësh mendjen edhe një herë, në lidhje me dallimet midis dy zhanreve letrare të ndryshme, por edhe të trazuara me njëra-tjetrën. Një arsye për këtë mund të jetë lajthitja për t'i ngatërruar ndryshimet e gjatësisë së tekstit me dallimin gjinore midis tregimit të shkurtër dhe tregimit të gjatë. Ndryshim që është i vlefshëm midis një tregimi dhe një tjetri, por jo midis tregimit dhe romanit.

Tregimi më i shkurtër që njoh është ai i guatemalasit Augusto Monteroso, i cili sapo ka marrë çmimit "Princit të Asturias". Ja tregimi:

*Kur u zgjua, dinozauri ishte akoma atje.*

Asgjë më shumë. Ka edhe një tjetër nga *Një mijë e një net*, tekstin e të cilit nuk e kam në dorë dhe më prodhon ngërçe zilie. Është historia e një peshkatari që i merr hua një plumb rrjete një gruaja të një peshkatari tjetër, me premtimin se do t'i dhuronte peshkun e parë që do të kapte; dhe kur ajo e merr peshkun dhe e hap për ta tiganisur, në barkun e tij gjen një diamant me madhësinë e një bajame.

Më shumë sesa vetë rrëfenja, e mahnitshme për thjeshtësinë e saj, kjo më intereson tani sepse shtjellon tjetër nga misteret e zhanrit: nëse plumbin nuk do ta kishte dhënë një grua, por një burrë tjetër, historia do të humbiste sharmin: nuk do të ekzistonte. Pse? Kush e di! Një mister më shumë i një zhanri misterioz në shkallën më të lartë.

Romanet shembullore të Servantesit janë vërtet shembullore, por disa nuk janë romane. Përkundrazi, Josef Konrad shkroi tregimin *Duelistët*, po ashtu një histori shembullore, me më shumë se njëqind e njëzet faqe, që shpesh ngatërrohet me një roman për shkak të gjatësisë së tij. Regjisori Ridley Scott e bëri atë një film të shkëlqyeshëm, pa ndryshuar identitetin e historisë së tij. Absurdja në këtë pikë do të ishte të pyesim nëse Konradit do t'i interesonte që ta ngatërronin vërtet me një roman.

Intensiteti dhe uniteti i brendshëm janë thelbësore në një tregim, ndërsa në një roman jo aq shumë, sepse në një roman, fatmirësisht, ka mjete të tjera për të na magjepsur. Prandaj, kur dikush sapo lexon një tregim, mund të imagjinohet se çfarë përjeton para dhe pas, dhe e gjithë kjo do të vazhdojë të mbetet pjesë e temës dhe magjisë së asaj që lexoi. Përkundrazi, romani duhet të mbajë gjithçka brenda. Përfundimisht, mund të thuhet, pa frikë, se ndryshimi mund të jetë po aq subjektiv sa edhe për gjithë bukuritë e jetës reale.

Shembuj të mirë për tregime kompakte dhe intensive janë dy perlat e këtij zhanri: *Këmba e majmunit* e V. V. Jacobsit dhe *Njeriu në rrugë* i Zhorzh Simenonit. Tregimi policor mbijeton në botën e tij të veçantë, pa nevojën e shoqërimit, sepse shumica e simpatizantëve të tij interesohen më shumë për intrigën sesa për misterin. Veçanërisht tek më i vjetri dhe i paarritshmi Edipi mbret, i Sofokliut, një dramë greke që ka unitetin dhe tensionin e jashtëzakonshëm të një rrëfimi, ku hetuesi zbulon se ai vetë është vrasësi i babait të tij.

Tregimi duket se është gjinia natyrore e njerëzimit për përfshirjen e saj spontane në jetën e përditshme. Ndoshta, pa e ditur, atë e shpiku njeriu i parë i shpellave që, një pasdite, doli për të gjuajtur dhe nuk u kthye deri ditën tjetër, për shkak se iu desh të luftonte për jetë a vdekjeje kundër një bishe të çmendur nga uria. Në të vërtetë, ajo që bëri gruaja e tij, kur kuptoi se heroizmi i burrit nuk ishte gjë tjetër veçse një përrallë, mundi të ishte romani i parë dhe mbase më i gjati i epokës së gurit.

Nuk di çfarë të them për supozimin nëse tregimi qenka një pauzë freskimi midis dy romaneve, kjo gjë mund të jetë një spekulim teorik që nuk ka asnjë lidhje me përvojat e mia si shkrimtar. Duke e vrarë mendjen shumë, do të guxoja të thosha se nuk janë të paktë shkrimtarët që i kanë provuar të dy zhanret në të njëjtën kohë dhe jo shumë herë me të njëjtën fat në të dy zhanret. I tillë është rasti i Uilliam Samerset Mom, veprat e të cilit – si ato Heminguejt – janë më të njohurat nga kinemaja. Midis tregimeve të tij të shumta, nuk mund të harrojmë *P&O* – sigël e kompanisë e lundrimit "Pacific and Orient" – e cila është drama e tmerrshme dhe patetike e një kolonizuesi të pasur anglez që vdes nga një hipostazë e pamëshirshme në mes të Oqeanit Indian.

Ernest Heminguej është një rast i ngjashëm. Sa i njohur për kinemanë aq edhe për librat e tij, ai mund të mbetet në historinë e letërsisë vetëm për disa tregime mjeshtërore. Duke studiuar jetën e tij, mendohet se prirja dhe talenti i tij i vërtetë ishin për tregimin e shkurtër. Për shijen time, krijimet më të mira nuk janë as më të vlerësuarat as më të gjatat. Përkundrazi, dy prej tyre janë një nga më të shkurtrat – *Një kanarinë për një dhuratë* dhe *Një mace në shi* – dhe e treta, e gjatë dhe e shenjtë, *Jeta e shkurtër dhe e lumtur e Francis Makomberit.*

Mbi supozimin tjetër se tregimi mund të jetë një lloj praktike për të arritur te romani, pohoj që e kam bërë dhe nuk më ka dalë keq për të mësuar të shkruaj romanin *Vjeshta e patriarkut*. E kisha mendjen të fiksuar te formula tradicionale e *Njëqind vjet vetmi*, për të cilin kisha punuar dy vjet, pa e ngritur kokën. Çdo gjë që përpiqesha të shkruaja më dilte njësoj dhe nuk arrija dot të manovroja për një libër tjetër. Sidoqoftë, bota e diktatorit të përjetshëm, të ftilluar dhe të shkruar në stilin e gjykueshëm të librave të mëparshëm, do të kishte jo më pak se dy mijë faqe rrotulla letre të padepërtueshme dhe të padobishme. Kështu që vendosa të shikoja çdo rrezik për një prozë të ngjeshur që do të më nxirrte nga kurthi akademik për ta ftuar lexuesin në një aventurë të re.

Mendova se e kisha gjetur zgjidhjen përmes një seri shënimesh dhe idesh për tregime të lëna, të cilëve iu ktheva, pa drojën më të vogël nga çdo lloj arbitrariteti formal, derisa gjeta atë që po kërkoja për librin e ri. Janë tregime eksperimentale për të cilat kisha punuar për më shumë se një vit dhe që u botuan më vonë më vete te libri *Zemërdëlira Eréndira*: *Blakaman shitësi i mirë i mrekullive* dhe *Udhëtimi i fundit i anijes fantazmë*, që është një fjali e vetme pa pikësim, përveç presjeve apo, aty këtu, ndonjë pikëpresje, sa për të marrë frymë – dhe disa tregime të tjerë që nuk e kaluan provimin dhe që flenë gjumin e të drejtit në sirtarin e plehrave. Kështu gjeta embrionin e *Vjeshta e patriarkut*, që është një sallatë ruse eksperimentesh të kopjuara nga shkrimtarë të tjerë të këqij apo të mirë të shekullit të kaluar. Frazat që do të donin dhjetëra faqe janë zgjidhur në dy ose tri faqe, për të thënë të njëjtën gjë, duke u zënë ngushtë, nga shkelja e vetëdijshme e rregullave të kursimit dhe gramatikës diktatoriale të akademive.

Libri që doli ishte një katastrofë tregtare. Shumë lexues, besnikë të romanit *Njëqind vjet vetmi*, u ndjejnë të zhgënjyer dhe donin që shitësi i librave t'u kthente paratë. Duke qenë se libri qe lidhur shkel e shko, për të kursyer sa më shumë, botimi spanjoll do të më mbetej në dorë dhe një mik, duke bërë shaka, më ngushëlloi: "E lexova Vjeshtën tënde, gjethe më gjethe". Shumë këmbëngulën në lexim, të tjerët mezi arrinin te gjysma dhe, me kohë, më shmangeshin, se mos më vinte keq që nuk vazhdonin më tej. Sot është libri im më i shqyrtuar në universitete të vendeve të ndryshme, dhe gjeneratat e reja mund ta lexojnë sikur të ishte muzgu i një Tarzani dyqind vjeç. Nëse dikush proteston dhe e hedh nga dritarja, kjo ndodh ngaqë nuk i pëlqen, por jo sepse nuk e kupton. Dhe ndonjëherë, për fat të mirë, ka edhe ndonjë që e merr përsëri nga toka.




Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# 'Fshesa' e presidentit të Dritës po funksionin, shkon në pesë numri i largimeve

Sulmuesi Marko Simonovski dhe Almir Kryeziu e kanë dërguar në pesë numrin e largimeve nga skuadra e Dritës së Gjilanit që prej përfundimit të edicionit 2022/2023. Gazeta mëson se në ditët e ardhshme pritet të ketë edhe largime të tjera nga ky klub, kurse deri tash kontratën me nënkampionët e Kosovës e ka vazhduar vetëm mesfushori Rron Broja



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Skuadra e Dritës e humbi mundësinë që të shpallet kampione në Superligën e futbollit të Kosovës në javët e fundit, kur këtë sukses e rrëmbeu Ballkani nga Suhareka që për të dytën herë me radhë shpallet kampion.
Presidenti i klubit gjilanas, Valon Murseli, kishte paralajmëruar "fshesën" pasi klubi i tij dështoi të shpallet kampion dhe duket se kjo "fshesë" po funksionon për mrekulli, pasi deri tash janë kompletuar pesë largime nga ky klub, përfshirë edhe kapitenin dhe ikonën e Dritës, Ardian Limani, ani pse ky i fundit ka thënë se vendimi për largim ishte i tij dhe jo i klubit. "Pas insistimit tim të vazhdueshëm te klubi kam arritur marrëveshje që të ndërpres bashkëpunimin me vullnetin tim të plotë. Për këtë gjë e falënderoj klubin pafundësisht për mirëkuptimin ndaj meje, në krye me presidentët e klubit, Valon Murseli e Flamur Bunjaku, si dhe stafin drejtues të klubit. Pas një sezoni dëshpërues dhe rezultateve jo të pritura të klubit, e kam parë të rrugës të ndërmarr një hap të tillë duke konsideruar se është koha e duhur që klubi të bëjë ndryshime. Ani pse klubi ka insistuar vazhdimisht që unë të vazhdoj t'i prij skuadrës drejt synimeve të veta, unë kam insistuar të kundërtën, duke lënë hapësirë për energjitë e reja", ka thënë Limani.
Përveç "Ardit", ishin larguar edhe Hamdi Namani dhe Ilir Blakçori, derisa të enjten ka njoftuar edhe për largimin e topgolashënuesit Marko Simonovski. "Marko Simonovski dhe klubi ynë kanë mbyllur bashkëpunimin pas përfundimit të kontratës mes dy palëve. Simonovski erdhi te ne në sezonin 2021/22 dhe gjatë periudhës dyvjeçare arriti 70 paraqitje në të gjitha kompeticionet duke shënuar 32 gola dhe 6 asistime. Klubi ynë e falënderon Markon për kontributin e dhënë dhe i dëshiron shumë suksese në vazhdim të karrierës", thuhet në njoftimin e Dritës.
Të enjten largimin nga skuadra nënkampione e ka bërë me dije edhe Almir Kryeziu, i cili për dy vjet e djersiti fanellën e Dritës. "Ju njoftoj që pas dy vjetësh te kaluara me FC Drita, i kam dhënë fund bashkëpunimit me këtë klub. Dua ta falënderoj klubin për bashkëpunimin, gjithashtu trajnerët dhe stafin e tyre, stafin mjekësor, ekonomët dhe të gjithë ata që kanë dhënë kontribut për klubin. Falënderim të veçantë për tifozët 'Intelektualet' që i kanë qëndruar pranë klubit në çdo kohë. Klubit i uroj suksese në arritjen e synimeve të veta", ka thënë Kryeziu. Deri tash vetëm Rron Broja e ka vazhduar kontratën me skuadrën e Dritës nga Gjilani, kurse kësaj skuadre me shumë gjasa do t'i bashkohet edhe mbrojtësi Ahmet Haliti.

## SHKURT

### Napoli dhe Milani në garë për Zhegrovën

Reprezentuesi i Kosovës dhe anëtari i Lilles, Edon Zhegrova, është shndërruar në objektiv të dy skuadrave italiane, Napoli dhe Milan. Zhegrova ka kontratë me Lillen deri në qershor 2026, kurse Napoli po e sheh si një zëvendësues ideal për Hirving Lozanon, i cili mund të largohet nga "Stadio Maradona" në verë, duke pasur klube të Premierligës dhe Ligës 1 të interesuara për nënshkrimin e tij. Në anën tjetër, edhe Milani e dëshiron 24-vjeçarin nga Prishtina, pasi konsiderohet një lojtar i nevojshëm për klubin kuqezi.

### Gjokoviqi nuk heq dorë nga mesazhi i tij provokues

Tenisti serb Novak Gjokoviq ka thënë se "është i vetëdijshëm se njerëzit mund të mos pajtohen" me të pas mesazhit të fundit në "Roland Garros". Ashtu edhe siç njihet, një sportist provokator, Gjokoviqi, shkroi në ndeshjen e parë në turneun francez "Kosova është zemra e Serbisë. Stop dhunës", duke nxitur reagime në opinion. Në një intervistë të shkurtër, Gjokoviqi ka thënë se ai "e mbron", akoma mesazhin e tij edhe pse njerëzit nuk mund të pajtohen me të, raporton "BBC". Tenisti serb është akuzuar për përfshirje në çështje politike, por organizatorët e turneut nuk kanë vendosur ta dënojnë. Ai është qortuar edhe nga ministrja e Sportit në Francë. Mesazhi i Gjokoviqit erdhi pas tensioneve të shkaktuara në veri të Kosovës. Ai njihet për mesazhe provokuese dhe kundërthënëse tash e sa kohë.

### Zyrtare: Messi largohet PSG-ja

Ylli argjentinas Lionel Messi do të largohet në fund të këtij edicioni nga Paris Saint-Germaini. Lajmin e ka dhënë trajneri Christophe Galtier. "Kisha privilegjin ta trajnoja lojtarin më të mirë në histori të futbollit. Do të jetë ndeshja e fundit e Leos në 'Parc des Princes' ndaj Clermontit", ka deklaruar Galtier. Ditët e fundit është raportuar se Messi mund të rikthehet në Barcelonë, por për argjentinasin ka interesim edhe nga Arabia Saudite.

### KH Vëllaznimi vazhdon në Superligë

Vëllaznimi i Gjakovës vazhdon të jetë në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Të mërkurën në Prishtinë, Vëllaznimi e mposhti Samadrexhën në ndeshjen e plejautit. Ndeshja përfundoi me rezultat 33:27 në të mirë të skuadrës gjakovare. Samadrexha kështu mbetet në Ligën e Parë. Samadrexha nisi ndeshjen me 3:0 e më pas Vëllaznimi kaloi para 9:5. Më pas skuadra gjakovare ka mbajtur epërsi prej disa golash. Samadrexha u afrua në 18:16 në minutën e 34-t, por Vëllaznimi u shkëput sërish në 21:17. Dhe pastaj kontrolloi ndeshjen deri në fund.
Arbër Neziri i shënoi nëntë gola për Vëllaznimin, ndërsa shtatë i kishte Florian Rexha. Anton Maloku shënoi tetë gola për Samadrexhën, ndërsa gjashtë i shtoi Bledon Maloku.

## Dion Berisha zyrtarizohet në Bayern

MUNCHEN, 1 QERSHOR - Bayern Munchen ka nënshkruar kontratë me futbollistin e Përfaqësueses së Kosovës U21, Dion Berisha. Lajmin e ka konfirmuar klubi "bavarez" që e konfirmoi këtë lajm përmes rrjeteve sociale. "Dioni është talent ambicioz dhe ka punuar me përkushtim të madh tek ekipi i Augsburgut. Ai ka fituar tashmë përvojë në ligën rajonale dhe ne jemi shumë të kënaqur që ai tani dëshiron t'i kapë majat në të ardhmen në futbollin profesionist", ka thënë drejtori sportiv i Bayern Munchen Campus, Halil Altintop. Dion Berisha pati debutuar me kombëtaren e Kosovës U15 në vitin 2018, ndërsa ishte pjesë e Augsburgut, kurse nga edicioni i ri do të luajë për Bayernin II me trajner Holger Seitz, që bën gara në ligën rajonale.



## Krasniqi në Madrid për Konventën e Mini Basketbollit

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Nga 2 deri më 4 qershor në Madrid të Spanjës do të mbahet Konventa e Mini Basketbollit. Federata e Basketbollit e Kosovës do të paraqitet nga drejtori Teknik i FBK-së, Arben Krasniqi. Minibasketbolli është duke shënuar rritje të jashtëzakonshme dhe FIBA Europe e ka cilësuar se federatat kanë nevojë për më shumë trajnerë të Mini Basketbollit, të cilët janë në gjendje ta ofrojnë mjedisin e nevojshëm për fëmijët, duke mësuar se si ta luajnë lojën e basketbollit. Kjo konventë është pjesë përmbyllëse e trajnimit të kursit për trajnerë të MiniBasketbollit 2022/23 të organizuar nga FIBA Europe dhe me përfundimin e suksesshëm të këtij kursi do të zgjedhen edhe instruktorët nacionalë të Mini Basketbollit nëpër federatat përkatëse.



# 20 klubet që kanë shpenzuar më së shumti në pesë vitet e fundit



LISTA E 20 KLUBEVE:

| | |
|---|---|
| Chelsea: | 1,2 miliardë euro |
| Juventus: | 837 milionë |
| Barcelona: | 776 milionë |
| Manchester United: | 769 milionë |
| Manchester City: | 708 milionë |
| Arsenal: | 674 milionë |
| PSG: | 646 milionë |
| Real Madrid: | 629 milionë |
| Atletico Madrid: | 587 milionë |
| West Ham: | 524 milionë |
| Wolverhampton: | 516 milionë |
| Aston Villa: | 507 milionë |
| Liverpool: | 494 milionë |
| Tottenham: | 493 milionë |
| Newcastle: | 479 milionë |
| Monaco: | 478 milionë |
| Roma: | 465 milionë |
| Milan: | 455 milionë |
| Inter: | 445 milionë |
| Napoli: | 438 milionë |

LONDËR, 1 QERSHOR - Sajti i specializuar "Tifosy" ka publikuar shifrat e shpenzimeve të klubeve në merkato në pesë sezonet e fundit teksa vihet re dominimi absolut i Chelseas. Londinezët kanë shpenzuar plot 1.2 miliard euro në pesë vitet e fundit, teksa vlen të theksohet se plot 588 milionë euro, ose 49 % e totalit, i ka shpenzuar vetëm në vitin e fundit, nën presidencën e Tod Boehly. Pas londinezëve, klubi i dytë që ka shpenzuar më shumë është Juventusi, që ka çuar 837 milionë euro për merkaton në pesë vitet e fundit. Podiumin e plotëson Barcelona, me 776 milionë euro të shpenzuara, ndërsa 20-shën e parë e mbyllin katër skuadra italiane si Roma me 465 milionë euro, Milani me 455 milionë euro, Interi me 445 milionë euro dhe Napoli me 438 milionë euro.

# Ferrari: Në Spanjë modifikimet e reja, pastaj duelojmë për fitore



MARANELLO, 1 QERSHOR - Drejtori sportiv i Ferrarit, Frederic Vasseur, ka rrëfyer se duke nisur nga gara e Spanjës, te makina italiane do të vijnë modifikimet e para të rëndësishme. Modifikime që pritet t'i japin një tjetër shtysë në pistë "kokëkuqes", që deri më tani ka zhgënjyer këtë sezon te Formula 1. "Duhet t'i analizojmë forcat tona, dobësitë tona dhe t'i bashkojmë të gjitha për ta përmirësuar makinën tonë", ka thënë Vasseur në një intervistë për "Gazzetta Dello Sport". "Në garën e Montmelo do të vijë një paketë e re që do të montohet në makinë", ka deklaruar më tej Vasseur. "Bëhet fjalë për disa ndryshime aerodinamike, por jo në pjesën e pasme të makinës. Do ta testojmë në garën e Spanjës për të parë më pas nëse do ta aplikojmë në pistat e tjera. E sigurt është se do të jemi si gjithnjë në garë për të siguruar 'pole' në çdo pistë", ka shtuar Vasseur. "Natyrisht që kemi edhe probleme me gomat në garë, por sapo t'i sistemojmë disa zgjidhje për problemet që kemi hasur deri më tani, do ta synojmë fitoren. Këtë do ta bëjmë duke synuar vendin e parë që të shtunën në provat zyrtare e më pas në garën e së dielës", u shpreh shefi i Ferrarit.

## SHKURT

### Berisha do të largohet nga Torino

Portierit të Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, i skadon kontrata me Torinon në verën e ardhshme, por mediet italiane raportojnë se portieri shqiptar nuk bën pjesë në planet e kësaj skuadre dhe pritet të largohet gjatë verës. Ende nuk dihet se a ka ndonjë skuadër të interesuar për "gardianin" shqiptar, kurse zgjidhja e vetme për të mos mbetur pa luajtur në sezonin e ardhshëm, sipas medieve italiane, është largimi nga Italia dhe me shumë gjasa pritet të ndodhë diçka e tillë. Berisha më parë ishte pjesë e skuadrave si Lazio, Atalanta e SPAL në Serinë A.

### Trajneri i Sevillas: Ende se besoj se fituam

Jose Luis Mendilibar ka bërë një punë të jashtëzakonshme në krye të Sevillas në vetëm 16 ndeshje, duke i dhënë një trofe dhe duke e shpëtuar nga rënia nga kategoria. Për herë të shtatë andaluzianët fituan trofeun e Ligës së Evropës, duke triumfuar në të gjithë finalet e luajtura. "Ende nuk e besoj që kemi fituar, por ne luftuam dhe trofeu i Ligës së Evropës është yni. Ndeshjen e nisëm keq, pasi nuk depërtuam shumë në zonën e Romës. Por pjesa e dytë ishte një tjetër simfoni. Arritëm të shkonin shpeshherë në zonën e tyre dhe barazuam rezultatin. Për sa iu përket penalltive, lojtarët ishin të caktuar. Megjithatë, ata e ndryshuan vetë rendin mes tyre gjatë zhvillimit të penalltive", ka thënë Mendilibar.

### Benzema, një hap larg transferimit në Arabinë Saudite

Lajme të bujshme vijnë nga Spanja, nga ku raportohet se sulmuesi i Real Madridit, Karim Benzema, është një hap larg transferimit në Arabinë Saudite, te klubi i Al Ittihad. Marrëveshja raportohet se është pothuajse e mbyllur dhe francezi do të marrë një pagë prej 100 milionë eurosh në vit nëse do të bashkohet me kundërshtarët e Cristiano Ronaldos, njëkohësisht kampionët e këtij sezoni në Arabinë Saudite. Kontrata e Benzemas me Realin përfundon më 30 qershor, gjë që e bën sulmuesin të largohet nga madrilenët me parametra zero pas 14 vjetësh.

### Mourinho: Më duhen të arta, nuk i mbaj të argjendit

Trajneri Jose Mourinho humbi finalen e parë në karrierë. Trajneri portugez u dorëzua përballë Sevillës në finalen e Ligës së Evropës. Menjëherë pasi mori medaljen e argjendtë, tekniku i njohur zgjodhi që t'ia dhuronte një tifozi. Më pas Mourinho ka shpjeguar gjithçka: "Mua më duhen vetëm medaljet e arta, nuk më duhen ato të argjendit, prandaj i dhurova".

## Hamsik njofton pensionimin nga futbolli

Marek Hamsik ka njoftuar pensionimin e tij nga futbolli. Mesfushori 35-vjeçar sllovak bëri njoftimin e tij zyrtar në një konferencë për shtyp."Trabzonspor do të jetë ekipi im i fundit dhe unë do ta luaj ndeshjen time të fundit në shtëpi të shtunën. Dua t'i falënderoj të gjitha klubet për të cilat kam luajtur që ma dhanë këtë mundësi. Faleminderit të gjithëve për këtë udhëtim! Unë e realizova ëndrrën time. Sapo linda, futbolli ishte gjëja e parë që më erdhi në mendje. Ky ishte fati im. Karrierën e fillova në moshën katërvjeçare, kisha ëndrra të mëdha dhe mendoj se i kam arritur qëllimet e mia. Dua ta falënderoj familjen dhe miqtë e mi që kanë qenë pranë meje për besimin tek unë. Faleminderit tifozëve që më kanë mbështetur! Tani do të shijoj këto momente të fundit, ndeshjet e fundit. Mund të mos qaj, por jam shumë i lumtur dhe krenar", ka deklaruar Hamsik. Marek Hamsik u bë i njohur me fanellën e Napolit, ku në 520 ndeshje të luajtura në total, ai shënoi 121 gola dhe asistoi 103 të tillë.

DRINI I BARDHË

K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudriniibardhe.com

Në bazë të rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës, KRU "Drini i Bardhë" Sh.A, me datën 02.06.2023 shpallë këtë:

***KONKURS***

**Pozita: Menaxher i njësisë operative, me kontratë pune një vjeçare me mundësi vazhdimi, pune provuese gjashte (6) muaj, vendi Deçan (1 pozitë), Gurrakoc (1 pozitë).**
**Pozita: Inkasantë sezonal për teren, Vendi Pejë (3 pozita), Deçan (3 pozita), Gurrakoc (2 pozita).**

**Detyrat e punës për Menaxher të njësisë janë:**

- Menaxhon më njësinë operative, harton propozim planin vjetor të punës dhe kujdeset për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e aseteve, përcjell realizimin e planit vjetor, është përgjegjës për disiplinën në punë dhe azhurnimin brenda njësisë.
-

**Kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës**:

- Diploma universitare drejtimi ekonomik, bujqësisë ose juridik,
- Përvoja e punës prej 3 viteve në vende të ngjashme të punës.

**Detyrat e punës për inkasant sezonal janë:**

-Bëjnë pastrimin e kanaleve të ujitjes sipas planifikimit nga Menaxheri i Njësisë, bëjnë kontraktimin e ujit, shpërndarjen e ujit, dhe pagesat nga fermerët, më rastin e pagesave janë të obliguar të lëshojnë kontrata dhe dëftesat e pagesave.
**Kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës.**

- Kualifikimi fillor ose i mesëm shkollor.

**Procedura e aplikimit:**

Dokumentet dorëzohen ne zyrën nr.1 të KRU "Drini i Bardhë'' rruga "Mbretëresha Teutë" Nr. 85 Pejë.

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit, dëshminë e përvojës se punës,
- Diplomën shkollore për kualifikimin e kërkuar - kopje,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit dhe përfundon në ora 16:00, të ditës gjegjëse.

DRINI I BARDHË

K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudriniibardhe.com

Na osnovu Uredbe o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji poslova i radnih zadataka, KRU "Drini i Bardhe" Sh.A., od 02.06.2023. godine, objavljuje:

**KONKURS**

Funkcija: Menadžer operativne jedinice, sa jednogodišnjim ugovorom sa mogućnošću produženja, šest (6) meseci probnog rada, Dečani (1 pozicija), Gurakovc (1 pozicija). Pozicije: sezonski sakupljač polja, lokacija Peć (3 pozicije), Dečane (3 pozicije), Gurakovac (2 pozicije).

**Dužnosti upravnika jedinice su:**

- Rukovodi operativnom jedinicom, izrađuje predlog godišnjeg plana rada i stara se o korišćenju i održavanju imovine, nadgleda sprovođenje godišnjeg plana, odgovoran je za radnu disciplinu i ažuriranje u okviru jedinice.

**Uslovi za zasnivanje radnog odnosa:**

- fakultetsku diplomu ekonomije, poljoprivrede ili prava,

- Radno iskustvo od 3 godine na sličnim radnim mestima.

Dužnosti sezonskog sakupljača su:

-Čiste kanale za navodnjavanje po planu direktora jedinice, ugovaraju vodu, distribuciju vode, isplate od poljoprivrednika, u slučaju plaćanja dužni su da izdaju ugovore i račune.

Uslovi za zasnivanje radnog odnosa.

- Osnovna ili srednja školska sprema.

**Aplikacija postupak:**

Dokumenti se predaju u kancelariju br.1 KRU "Drini i Bardhe" ulica "Mbreteresha Teute" br. 85 Peć.

**Uz prijavu je potrebno priložiti i sledeća dokumenta:**

. CV (biografija),

. Kopija lične karte, dokaz o radnom iskustvu,

. Školska diploma o traženoj stručnoj spremi - kopija,

. Dokaz da niste pod istragom, ne stariji od šest (6) meseci.

**Rok za podnošenje prijava je 15 dana od dana objavljivanja konkursa i završava se odgovarajućeg dana u 16:00 časova.**







## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Meriton Osmani shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e Gjimnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

- Veton Aliu, shpall te pavlefshme dëftesën e 11 klase te shkollës se mesme ''ARKITEKT SINANI''.

- Bleona Binaku, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ''FRANG BARDHI''.

- Merlind Qorri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. III të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Remzi Kida nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 11 të Gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Flamur Godeni nga Gajkova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit" Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Besart Myftari B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 811937046.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Pozita:** Administrator/e i/e bazave të të dhënave (zyrtar i lartë)
**Departamenti:** Teknologjia Informative
**Divizioni:** Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
**I raporton:** Udhëheqësit të Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
**Grada:** 5
**Paga bazë:** 1183.47€

**Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:**
- Administron bazat e të dhënave për aplikacionet që zhvillohen në Departamentin e Teknologjisë Informative;
- Planifikon krijimin dhe mirëmbajtjen e bazave të të dhënave. Punon ngushtë me administratorët e sistemeve gjatë instalimit të aplikacioneve të cilat lidhen me bazat e të dhënave;
- Instalon versione të reja të databazave dhe veglave të saj, si dhe veglave të tjera të nevojshme për qasje në baza të të dhënave;
- Vlerëson versionet e databazave, veglave ndihmëse, në mënyrë që të sigurojë se baza e të dhënave punon sipas standardeve. Në bashkëpunim me administratorët e tjerë dhe zhvilluesit e aplikacioneve, planifikon përditësime me ndikim minimal në punën e sistemeve;
- Administruesi i bazave të të dhënave është edhe pikë kontakti me Oracle dhe Microsoft Support, si dhe kompanitë e tjera që kanë aplikacione dhe baza të të dhënave në BQK;
- Shkruan procedura (Ang. "stored procedures") të cilat përdoren për nxjerrjen e raporteve nga bazat e të dhënave në Oracle;
- Shkruan dokumentin udhëzues për përdorim të databazave;
- Rregullon problemet e ndryshme në bazat e të dhënave, aplikacioneve, komunikimin në mes tyre dhe veglave të tjera të cilat raportohen nga shfrytëzuesit;
- Monitoron dhe në rast të problemeve, rregullon problemet me komunikim në mes të databazave dhe aplikacioneve të ndryshme;
- Konfiguron bazat e të dhënave për "*high availability*";
- Planifikon, implementon dhe teston në mënyrë të vazhdueshme procedurat për backup dhe restore të bazave së të dhënave;
- Kryen proceset e EOD (End of Day) pas mbylljes se orarit;
- Kryen edhe detyra të tjera të caktuara nga udhëheqës-i/ja.

**Njohuritë e kërkuara:**
- Njohuri të shkëlqyeshme në administrimin e bazave të të dhënave të bazuara në Oracle ose MS SQL;
- Njohuri të shkëlqyeshme në dizajnimin logjik dhe fizik të bazave të të dhënave;
- Aftësi të kryejë rregullime në performancën e bazave të të dhënave;
- Të jetë i aftë të ofrojë strategji gjatë zhvillimit të bazave të të dhënave;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme në shkrimin e query të ndryshëm sipas nevojave dhe natyrës së punës;
- Njohuri të mirë të menaxhimit të të drejtave të shfrytëzuesve të bazave të të dhënave;
- Përvojë në migrime të bazave të të dhënave;
- Njohuri në performance tunning të bazave të të dhënave;
- Përvojë në T-SQL ose PL/SQL.

**Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:**
- Shkallë universitare (bachelor) në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës, ose certifikime profesionale për Oracle Database Administration Certified Professional, Oracle Certified Associate (OCA), Oracle Certified Professional (OCP), MS SQL Database Administration;
- Përvojë pune së paku 3 vjeçare në administrimin e bazave në Oracle ose MS SQL;
- Gjuha angleze - e preferuar.

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**
- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente;
- Raporti nga Trusti i cili e dëshmon periudhën kohore të përvojës së punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

**Procedura e aplikimit:**
- Afati i fundit për aplikim është **16 qershor 2023.**
- Aplikimi mund të bëhet online (https://hris.bqk-kos.org) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

**Pozicija:** Administrator baze podataka (viši službenik)
**Odeljenje:** Informaciona tehnologija
**Divizija:** Informaciona tehnologija i sistemi
**Izveštava:** Rukovodiocu Divizije za informacione tehnologije i sistema
**Stepen:** 5
**Osnovna mesečna plata:** 1183.47€

**Radne dužnosti i odgovornosti:**
- Administrira baze podataka za aplikacije razvijene u Odeljenju za informacionu tehnologiju;
- Planira kreiranje i održavanje baza podataka. Blisko sarađuje sa administratorima sistema tokom instalacije aplikacija vezanih za baze podataka;
- Instalira nove verzije baza podataka i njenih alata, kao i drugih alata potrebnih za pristup bazama podataka;
- Procenjuje verzije baza podataka, pomoćnih alata, kako bi obezbedio da baza podataka radi u skladu sa standardima. U saradnji sa drugim administratorima i razvijačima aplikacija, planira ažuriranja sa minimalnim uticajem na radu sistema;
- Administrator baze podataka je takođe kontaktna tačka sa Oracle i Microsoft SUpport, kao i drugim kompanijama koje imaju aplikacije i baze podataka u CBK;
- Piše procedure (eng. „stored procedures") koje se koriste za izdvajanje izveštaja iz baza podataka u Oracle-u;
- Piše dokument vodiča za korišćenje baza podataka;
- Popravlja različite probleme u bazama podataka, aplikacijama, komunikaciji između njih i drugim alatima koje prijavljuju korisnici;
- Prati i u slučaju problema rešava probleme u komunikaciji između različitih baza podataka i aplikacija;
- Konfiguriše baze podataka za "*high availability*";
- Planira, implementira i kontinuirano testira procedure za *backup* i *restore* baza podataka;
- Obavlja EOD (*End of Day*) procese nakon zatvaranja radnog vremena;
- Obavlja i druge poslove koje mu rukovodilac odredi.

**Potrebno znanje:**
- Odlično poznavanje administracije baza podataka zasnovanih na Oracle ili MS SQL;
- Odlično poznavanje logičkog i fizičkog dizajna baze podataka;
- Sposobnost izvođenja podešavanja u performansi baza podataka;
- Biti u stanju da obezbedi strategije tokom razvoja baza podataka;
- Odlične veštine pisanja različitih *query* prema potrebama i prirodi posla;
- Dobro poznavanje upravljanja pravima korisnika baza podataka;
- Iskustvo u migracijama baza podataka;
- Poznavanje *performance tunning* baze podataka;
- Iskustvo u T-SQL ili PL/SQL.

**Potrebne kvalifikacije i iskustvo:**
- Univerzitetska diploma (bačelor) iz oblasti računarskih nauka, elektrotehnike ili matematike ili stručne sertifikate za Oracle Database Administration Certified Professional, Oracle Certified Associate (OCA), Oracle Certified Professional (OCP), MS SQL Database Administration;
- Najmanje 3 godine radnog iskustva u administraciji baza podataka u Oracle ili MS SQL;
- Engleski jezik - poželjno.

**Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:**
- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno (motivaciono) pismo koje navodi vaše interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od strane nadležne institucije/organizacije;
- Izveštaj Trusta kojim se dokazuje vremenski period radnog iskustva;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosova moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom boravištu na Kosovu.

**Postupak apliciranja:**
- Krajnji rok za apliciranje je **16 jun 2023**.
- Apliciranje se može vršiti on-line (https://hris.bqk-kos.org) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhiva CBK-a. Nikakav drugi oblik apliciranja se neće uzeti u obzir.
- Obrazac aplikacije možete preuzeti preko zvanične stranice: www.bqk-kos.org
- **Nekompletna dokumentacija se neće uzeti u obzir. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**

BQK
BANKA QENDRORE E REPUBLIK□S S□ KOSOV□S
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

| | |
|---|---|
| **Pozita:** | Administrator/e i/e Sistemeve (zyrtar i lartë) |
| **Departamenti:** | Teknologjisë Informative |
| **Divizioni:** | Teknologjisë Informative dhe Sistemeve |
| **I raporton:** | Udhëheqësit të Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Sistemeve |
| **Niveli i gradës:** | 5 |
| **Paga bazë:** | 1183.47€ |

**Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:**

- Konfiguron, monitoron pajisjet në infrastrukturë të DTI, përfshirë serverë, storage, SAN switch dhe pajisje tjera përcjellëse,
- Konfiguron, instalon, monitoron dhe mirëmban sistemet operative në serverë fizik dhe virtual,
- Konfiguron, instalon, monitoron dhe mirëmban sistemet me role të caktuara, siç janë: Active Directory, File Server, IIS Server, MS Exchange Server, SQL Server, etj.
- Administron infrastrukturën e PKI, përfshirë menaxhimin e certifikatave,
- Konfiguron, instalon, monitoron dhe mirëmban replikimet e të dhënave dhe sistemeve në mes dy qendrave.
- Konfiguron, instalon, monitoron dhe mirëmban backup-ët e të dhënave dhe sistemeve.
- Shërben si nivel i dytë i trajtimit të incidenteve dhe problemeve tek të gjithë shfrytëzuesit e teknologjisë informative.
- Menaxhon infrastrukturën, duke përfshirë instalimet dhe shpërndarjen e azhurnimeve dhe ndryshimeve përmes Sistemit për menaxhimin e azhurnimeve
- Mirëmban licencat dhe komunikon me ofruesit e shërbimeve të jashtme.
- Konfiguron, instalon dhe përditëson softuerët në baza të rregullta në serverët dhe kompjuterët e shfrytëzuesve.
- Bashkëpunon ngushtë me Administratorët dhe teknikët brenda Divizionit dhe me zyrtarët e Divizionit të Sigurisë së Informacionit dhe Vazhdimësisë së Punës.
- Trajton dobësitë në infrastrukturë, në aspekt të sigurisë dhe përcjellë log-ët e sigurisë
- Përcjell dhe aplikon standardet e sigurisë së informacionit
- Monitoron dhe mirëmban sistemin e printimit.
- Merr pjesë aktive në përgatitjet dhe planifikimet afatshkurta dhe afatgjata të TI.
- Mirëmban dokumentim të konfigurimeve, krijon procedura dhe manuale për të gjitha pajisjet dhe shërbimet për të cilat është përgjegjës.
- Detyra tjera që i caktohen nga përgjegjësit në hierarkinë e Departamentit të Teknologjisë Informative

**Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:**

- Shkallë bachelor në shkenca kompjuterike ose certifikime përkatëse që lidhen me rolin e Administratorit të sistemeve të TI-së të bazuara në Microsoft.
- Përvojë së paku 3 vjeçare në administrim të sistemeve dhe sisteme operative Windows Server 2012 R2, 2016, 2019, 2022. Përvojë në sigurinë e sistemeve është e preferueshme.
- Njohuri në menaxhim të DNS, DHCP, PKI.
- Përvoja në ambiente komplekse të infrastrukturës së TI e preferuar.
- Përvoja ose certifikim në ITIL i preferuar.
- Përvoja në infrastrukturën Cloud e preferueshme
- Gjuha angleze, e preferuar.

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente;
- Raporti nga Trusti i cili e dëshmon periudhën kohore të përvojës së punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **16 qershor 2023.**
- Aplikimi mund të bëhet online (https://hris.bqk-kos.org) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**

BQK
BANKA QENDRORE E REPUBLIK□S S□ KOSOV□S
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## OGLASI ZA RADNA MESTA

| | |
|---|---|
| **Pozicija:** | Administrator sistema (viši službenik) |
| **Odeljenje:** | Informaciona tehnologija |
| **Divizija:** | Informaciona tehnologija i sistemi |
| **Izveštava:** | Rukovodiocu Divizije za informacionu tehnologiju i sisteme |
| **Nivo stepena:** | 5 |
| **Osnovna mesečna plata:** | 1183.47€ |

**Radne dužnosti i odgovornosti:**

- Konfiguriše, nadgleda opremu u infrastrukturi OIT, uključujući servere, *storage*, SAN *switch* i druge pompćne uređaje,
- Konfiguriše, instalira, nadgleda i održava operativne sisteme na fizičkim i virtuelnim serverima,
- Konfiguriše, instalira, nadgleda i održava sisteme sa dodeljenim ulogama, kao što su: *Active Directory, File Server, IIS Server, MS Exchange Server, SQL Server*, itd.
- Administrira PKI infrastrukturu, uključujući upravljanje sertifikatima,
- Konfiguriše, instalira, nadgleda i održava replikacije podataka i sistema između dva centra.
- Konfiguriše, instalira, nadgleda i održava rezervne kopije podataka i sistema.
- Služi kao drugi nivo rešavanja incidenata i problema za sve korisnike informacione tehnologije.
- Upravlja infrastrukturom, uključujući instalaciju i distribuciju ažuriranja i promena preko sistema za upravljanje ažuriranjima
- Održava licence i komunicira sa provajderima spoljnih usluga.
- Konfiguriše, instalira i ažurira softver na redovnoj osnovi na serverima i računarima korisnika.
- Blisko sarađuje sa administratorima i tehničarima u okviru Divizije i sa službenicima Sektora za bezbednost informacija i kontinuitet poslovanja.
- Rešava ranjivosti u infrastrukturi, u smislu bezbednosti i prati *log*-ove bezbednosti
- Prati i primenjuje standarde bezbednosti informacija
- Nadgleda i održava sistem štampanja.
- Aktivno učestvuje u kratkoročnim i dugoročnim IT pripremama i planiranju.
- Održava dokumentaciju konfiguracija, kreira procedure i priručnike za svu opremu i usluge za koje je odgovoran.
- Druge dužnosti koje po hijerarhiji Odeljenja za informacionu tehnologiju poveri odgovorni

**Potrebne kvalifikacije i iskustvo:**

- Nivo bačelor iz računarskih nauka ili relevantne sertifikate vezane za ulogu Administratora IT sistema zasnovanih na Microsoft-u.
- Najmanje 3 godine iskustva u administraciji sistema i operativnim sistemima Windovs Server 2012 R2, 2016, 2019, 2022. Poželjno je iskustvo u oblasti bezbednosti sistema.
- Poznavanje upravljanja DNS, DHCP, PKI.
- Poželjno iskustvo u složenim okruženjima IT infrastrukture.
- Poželjno iskustvo ili sertifikat u ITIL-u.
- Poželjno iskustvo u *Cloud* infrastrukturi
- Engleski jezik, poželjno.

**Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:**

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno (motivaciono) pismo koje navodi vaše interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od strane nadležne institucije/organizacije;
- Izveštaj Trusta kojim se dokazuje vremenski period radnog iskustva;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosova moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom boravištu na Kosovu.

**Postupak apliciranja:**

- Krajnji rok za apliciranje je **16 jun 2023**.
- Apliciranje se može vršiti on-line (https://hris.bqk-kos.org) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhiva CBK-a. Nikakav drugi oblik apliciranja se neće uzeti u obzir.
- Obrazac aplikacije možete preuzeti preko zvanične stranice: www.bqk-kos.org
- **Nekompletna dokumentacija se neće uzeti u obzir. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Pozita:** Administrator/e i/e Rrjetit (zyrtar i lartë)
**Departamenti:** Teknologjia Informative
**Divizioni:** Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
**Raporton tek:** Udhëheqësi i Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
**Grada:** 5
**Paga bazë:** 1183.47€

Administratori i Rrjetit është përgjegjës për administrimin, përmirësimin dhe avancimin e infrastrukturës së rrjetave të teknologjisë informative. Gjithashtu është përgjegjës për sigurinë e informacionit në infrastrukturën e rrjetit.

**Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:**

- Instalon, konfiguron, administron dhe mirëmban të gjitha komponentët e rrjetave (Router, Firewall, Switch, VOIP dhe pajisje tjera të rrjetës) që janë pjesë e infrastrukturë së TI-së në BQK.
- Konfiguron dhe mirëmban ndërlidhjet (VPN) me institucionet tjera.
- Analizon kërkesat për ndryshim ose shtim të funksioneve në rrjetin e BQK-së dhe ofron zgjidhje adekuate.
- Bashkëpunon ngusht me administratorët dhe teknikët brenda divizionit dhe me zyrtarët e Divizionit të Sigurisë së Informacionit dhe Vazhdimësisë së Punës.
- Trajton gjetjet nga monitorimet dhe raportet e sigurisë së informacionit.
- Shërben si nivel i dytë i trajtimit të incidenteve dhe problemeve tek të gjithë shfrytëzuesit e teknologjisë informative.
- Zgjidh problemet që raportohen nga shfrytëzuesit e brendshëm dhe të jashtëm të rrjetit të BQK.
- Monitoron dhe bën matje të performancës së komponentëve të rrjetave, duke përfshirë pajisjet e BQK-së në shfrytëzim nga shfrytëzuesit e jashtëm.
- Mirëmban licencat dhe komunikon me ofruesit e shërbimeve të jashtme.
- Planifikon dhe ofron zgjidhje bazuar në matjet e komponentëve për të siguruar vazhdimësinë dhe sigurinë e shërbimeve të rrjetit.
- Mirëmban dokumentim të konfigurimeve, krijon procedura dhe manuale për të gjitha pajisjet dhe shërbimet për të cilat është përgjegjës.
- Merr pjesë aktive në përgatitjet dhe planifikimet afatshkurta dhe afatgjata të TI.
- Aplikon udhëzimet dhe standardet e sigurisë.
- Detyra tjera që i caktohen nga përgjegjësit në hierarkinë e Departamentit të Teknologjisë Informative

**Kualifikimet dhe përvoja:**

- Shkallë bachelor në shkenca kompjuterike ose certifikime përkatëse që lidhen me rolin e Administratorit të rrjetit, CCNA, PCNSA, JNCIA.
- Përvojë 3 vjeçare në administrim të rrjetave. Përvoja në sigurinë e rrjetave është e preferuar.
- Përvoja në ambiente komplekse të infrastrukturës së TI e preferuar.
- Përvoja ose certifikim në ITIL i preferuar.
- Gjuha angleze e preferuar.

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente;
- Raporti nga Trusti i cili e dëshmon periudhën kohore të përvojës së punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **16 qershor 2023.**
- Aplikimi mund të bëhet online (https://hris.bqk-kos.org) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

**Pozicija:** Administrator mreže (viši službenik)
**Odeljenje:** Informaciona tehnologija
**Divizija:** Informacione tehnologije i sistemi
**Stepen:** **5**
**Izveštava:** Rukovodiocu Divizije za informacione tehnologije i sistema
**Osnovna mesečna plata:** 1183.47€

Administrator mreže je odgovoran za administraciju, poboljšanje i unapređenje mrežne infrastrukture informacione tehnologije. Takođe je odgovoran za bezbednost informacija u infrastrukturi mreže.

**Radne dužnosti i odgovornosti:**

- Instalira, konfiguriše, administrira i održava sve mrežne komponente (Router, Firevall, Switch, VOIP i druge mrežne uređaje) koje su deo IT infrastrukture u CBK.
- Konfiguriše i održava interkonekcije (VPN) sa drugim institucijama.
- Analizira zahteve za promenu ili dodavanje funkcija u mreži CBK-a i nudi adekvatna rešenja.
- Blisko sarađuje sa administratorima i tehničarima u okviru odeljenja i sa službenicima Divizije za bezbednost informacija i kontinuitet poslovanja.
- Bavi se nalazima od praćenja i izveštaja bezbednosti informacija.
- Služi kao drugi nivo rešavanja incidenata i problema za sve korisnike informacione tehnologije.
- Rešava probleme prijavljene od strane internih i eksternih korisnika mreže CBK-a.
- Prati i meri performansu mrežnih komponenti, uključujući opremu CBK-a koju koriste spoljni korisnici.
- Održava licence i komunicira sa spoljnim provajderima usluga.
- Planira i pruža rešenja zasnovana na merenjima komponenti kako bi se obezbedio kontinuitet i bezbednost mrežnih usluga.
- Održava konfiguracionu dokumentaciju, kreira procedure i priručnike za svu opremu i usluge za koje je odgovoran.
- Aktivno učestvuje u kratkoročnim i dugoročnim IT pripremama i planiranjima.
- Primenjuje smernice i standarde bezbednosti.
- Druge poslove koje po hijerarhiji Odeljenja za informacionu tehnologiju poveri odgovorni

**Kvalifikacije i iskustvo:**

- Nivo bačelor iz računarskih nauka ili relevantne sertifikate vezane za ulogu Administratora mreže, CCNA, PCNSA, JNCIA.
- 3 godine iskustva u administraciji mreža. Poželjno je iskustvo u bezbednosti mreža.
- Poželjno iskustvo u složenim okruženjima IT infrastrukture.
- Poželjno iskustvo ili sertifikat u ITIL-u.
- Engleski jezik - poželjno.

**Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:**

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno (motivaciono) pismo koje navodi vaše interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od strane nadležne institucije/organizacije;
- Izveštaj Trusta kojim se dokazuje vremenski period radnog iskustva;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosova moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom boravištu na Kosovu.

**Postupak apliciranja:**

- Krajnji rok za apliciranje je **16 jun 2023**.
- Apliciranje se može vršiti on-line (https://hris.bqk-kos.org) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhiva CBK-a. Nikakav drugi oblik apliciranja se neće uzeti u obzir.
- Obrazac aplikacije možete preuzeti preko zvanične stranice: www.bqk-kos.org
- **Nekompletna dokumentacija se neće uzeti u obzir. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues